

3PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: Rikonstruksion Shkolla "Ndre Mjeda"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

VLERA E FONDIT LIMIT: 198,944,392.07 (Njëqind e nentëdhjetë e tete milion e nentëqind e dyzet e kater mijë e treqind e nentëdhjetë e dy pike zero shtate) **lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkodër** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:
 - a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
 - b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe si dhe në Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021-2022-2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet dhe konkretisht **198,944,392.07** (njëqind e nëntëdhjetë e tetëmilion e nëntëqind e dyzet e katërmijë e treqind e nëntëdhjetë e dy pikë zero shtatë) lekë.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", *"Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën", "Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës",* si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatorit ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të

ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **198,944,392.07** (njëqind e nëntëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e dyzet e katërmijë e treqind e nëntëdhjetë e dy pikë zero shtatë) **lekë** që është sa vlera e fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2021-2022-2023 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar

në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrorjnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **99,472,196** (Nentedhjete e nente milion e katerqind e shtatedhjete e dy mijë e njeqind e nentedhjete e gjashte) lekë dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **397,888,784** (Treqind e nentedhjete e shtate milion e teteqind e tetedhjete e tete mijë e shtateqind e tetedhjete e kater)leke

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me sektorin publik,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
 - Fature tatimore perkatese.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4.. *ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne vecanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontrata e zbatuara ne te shkuaren dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”...Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:a) Për kontratat e punëve:*

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat **50%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **dyfishi** i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e vlerës monetare, punët e mëparshme të ngjashme janë minimalisht në vlerat **50%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **vlera limit e kontratës që prokurohet**, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar dhe përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këto mënyra, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, pika 8 *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sipas këtij neni, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), .., Udhezimi i K.M nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhezimin Nr.3 datë 15.02.2001 “Për Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lindi e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të vertetuar kërkesat e përcaktuara në nenin 39 pika 5/a dhe b, duhet të paraqesin Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit, Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim për punët e kryera me entet publike, që

Autoriteti Kontraktor te bindet qe operatori ekonomik me ane te dokumentacionit te paraqitur ploteson kriterin per pune te ngjashme ku shihen zerat e punimeve qe ka realizuar , koha e realizimit , dokumentacioni i kolaudimit dhe marrjes ne dorezim te objektit si dhe vleresimi i dhene nga Autoriteti Kontraktor,elemente te nevojshem per te gjykuar per plotesimin e kriterëve per pune te ngjashme.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi ne toke”

Kategoria NP-3 Niveli B “Rikonstruksion dhe M/M godina civile dhe industriale

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge autostrada mbikalime”

Kategoria NP-7 Niveli A “Ujesjellesa ,gazsjellesa,vepra kullimi e vaditje”

Kategoria NP-11 Niveli A “Ndertime per N/Stacione kabinat e transformatoreve...”

Kategoria NP-12 Niveli A “Punime te inxhinierise se mjedisit”

Punime speciale ndertimi:

Kategoria NS-1 Niveli A “Punime per prishjen e ndertimeve ...”

Kategoria NS-2 Niveli A “Impiante H/Sanitare kuzhina lavanteri M/M e tyre.

Kategoria NS-4 Niveli B “Punime rifiniture te muratures.....”

Kategoria NS-8 Niveli A “Ndertime p/f me beton te armuar struktura metalike dhe druri”.

Kategoria NS-12 Niveli A “Impiante teknologjike,termike dhe te kondicionimit”.

Kategoria NS-13 Niveli A “Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni”

Kategoria NS-14 Niveli A “Impiante te brendshme elektrike ,telefonike,radiofoni,TV.

Kategoria NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”.

NP-1 A

Punime germimi në tokë

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime germimi në tokë *konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.*

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gërmimi, sistemimi të dherave dhe ndryshime të volumit të tokës, si rezultat rikonstruksionit te shkolles.

Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gërmimit të dheut për shtesen anesore 3 kate të shkolles.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.P - 3 B Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla *konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.*

Siç është parashikuar edhe në projekt kemi të bëjmë me një ndërtesë ekzistuese e cila është ndërtesë 40-vjeçare. Për këtë arsye dhe për të plotësuar nevojat e shkollës me klasa dhe me parametra bashkëkohore është e domosdoshme rikonstrukcioni i shkollës. Këto punime janë parashikuar në preventiv. Sipërfaqia totale e rikonstrukcionit të objektit ekzistues është 1782 m². Për zbatimin e punimeve të tilla është e nevojshme që të anagzhohen subjekte të specializuara, të cilët zotërojnë licensën N.P – 3. Kategoria B i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit

N.P - 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime që *përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore*

Këto punime janë parashikuar në preventiv, si shtrese stabilizant t=10cm, trotuar, me 6 cm beton, me pllaka, rrafshim, mbushje dheu me krah. Për zbatimin e punimeve të tilla është e nevojshme që të anagzhohen subjekte të specializuara, të cilët zotërojnë licensën N.P – 4. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit

N.P - 7 A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje

Sipas VKM nr. 42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla *konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit,*

funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura

Vendosja si kriter teknik i kësaj license lidhet ngushtë me tipologjinë e ndërhyrjeve që parashikohen për realizimin e këtij projekti.

Sistemi i furnizimit me ujë të ndërtesës është sistem i degëzuar me presion, i konceptuar të furnizohet me linjë kryesore nga rrjeti shpërndarës, por i mundësuar të furnizohet edhe me ngritje mekanike nga dhoma teknike (nëpërmjet depozitës së ujit dhe grupit të presionit), si by-pass i linjës së tubacionit kryesor nga pika e lidhjes me rrjetin shpërndarës.

Per sa me sipër në total vlerat për realizimin dhe kompletimin me strukturat e nevojshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje i përcaktojnë të tilla punime në kategorinë A sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar.

Kategoria NP-11 Niveli A (Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen për ndricimin, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë NP-11A, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P - 12 A Punime të inxhinierisë mjedisore

Si punime të tilla, në VKM nr.42 të datës 16.01.2008 konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rishtrukturuime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimin të kompaktësimin të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimin natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpatëve dhe rripullëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte.

Ndërhyrja objekt kontrate parashikon punime për rikonstrukcionin e godinës së shkolles 9 vjecare dhe ndertimin e shteses me kate. Ndërhyrje të tilla përfshihen në veprimtaritë me ndikim në mjedis. Projekti parashikon zhvillime të cilat sjellin detyrimisht ndikime në florën dhe faunën. Efektet kryesore në mjedis nga punimet për ndertimin e një objekti, konsistojnë në vija të përgjithshme si më poshtë: a) emetimet në ajër dhe zhurmat, b) shkarkimet në ujë, ndikimi në tokë, c) ndikimi në florë/faunë, ç) mbetjeve e prodhuara d) ndikime social-ekonomike, dh) ndikim në cilësinë e jetës në komunitetin përreth e)

ndikim në rritjen e trafikut rrugor, ë) ndikim në peizazhin e zones, h) ndikim në ndryshimet klimatike etj.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi, në fushën mjedisore, i cili i përfshin të tilla aktivitete në aktivitetet me ndikim në mjedis Autoriteti Kontraktor ka realizuar Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Raportin Teknik të VNM, si dhe ka marrë Vendimin për VNM Paraprake pranë Institucionit kompetent. Ndikimet në territor nga zbatimi i këtij projekti dhe masat për zbutjen e efekteve shtjellohen në Raportin e VNM.

Masat me efekt financiar për zbutjen e efekteve negative dhe riaftësimin e territorit janë përfshirë në preventivin e punimeve. Në preventiv parashikohen zëra të tillë si: transport materiale ndërtimi, dheu dhe depozitim i mbetjeve në landfill. Këto masa janë të nevojshme për procesin e riaftësimit natyror dhe botanik të territorit të përdorur për ndërtim me mbetje të mëdha inerte. Perpos kesaj ne preventiv eshte parashikuar mbjellja e fidaneve dekorative. Për realizimin e punimeve të parashikuara në preventiv dhe specifikime teknike për riaftësimin e territorit të parcelës ndërtimore është e nevojshme që OE të disponojë licensën përkatëse. Kategoria A i referohet vlerës totale të punimeve për riaftësimin e territorit dhe zbutjen e efekteve negative në preventivin e projektit të zbatimit. Kriteri në fjalë, është një kërkesë e domosdoshme në përputhje të plotë me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ushtron veprimtarinë e vetë në fushën e ndërtimit dhe ka kapacitetet teknike të nevojshme për zbatimin e kontrates. Kjo është një kërkesë minimale në përpjestim me vlerën dhe rëndësinë e kontratës që prokurohet, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, dhe që ka për qëllim të provojë se operatori ekonomik ka kapacitetet teknike për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

N.S –I A Punime për prishjen e ndërtimeve

Me punime të tilla, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar *konsideron çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.*

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Projekti i rikonstruksionit të shkollës është shoqëruar me prishjen e godinës në krahun verior të saj, rifiniturat dhe shtresat e objektit ekzistues janë të amortizuar, tarraca është me soletë dhe ka lagështirë në ditët me shi dhe në verë është shumë nxehtë për shkak të mungesës së termoizolimit dhe hidroizolimit, suvatimi i brendshëm është i vjetër, i amortizuar, me valëzime dhe e një cilësie të dobët, pllakat e dyshemesë janë granili të dëmtuara, shkallët janë të derdhura prej granili të cilat nuk janë bashkohore, tualetet (WC) janë të amortizuara totalisht. Per realizimin e rikonstruksionit fillimisht duhet bere prishja e pjeseve te amortizuara. Keto punime janë parashikuar në preventiv, si punime prishje te suvatimit ekzistues ne mure dhe tavane,prishje pllakash ekzistuese, cmontim dyer dhe dritare ekzistuese, prishje shkalle ekzistuese dhe shtrese me pllaka te sheshpushimet, prishje mur tulle objekti i vjeter, prishje struktura betoni, prishje e hidroizolimit

ekzistues (tarrace), heqje WC + kasete etj. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.S - 2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.

Me punime të tilla, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar *konsideron, montimin, mirëmbajtjen ose ristrukturimin e impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

Për zbatimin e projekteve të impianteve hidrosanitare dhe atyre të mbrojtjes nga zjarri, të parashikuara në projektin e zbatimit është e domosdoshme që OE të zotërojë kapacitetet përkatëse të konfirmuar me pikën përkatëse të licensës së nevojshme për zbatimin e punimeve të tilla, sikurse parashikohet në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 më sipër cituar. Vendosja e këtij kriteri i referohet zgjidhjeve grafike, preventivit, specifikimeve teknike, relacioneve të projektit hidroteknik dhe atij të mbrojtjes nga zjarri, si dhe grafikut të punimeve për zbatimin e projektit total. Në projektet respektive parashikohen impiantet hidrosanitare të furnizimit me ujë të tualeteve dhe të gjitha masat për mbrojtjen nga zjarri të objektit.

Këtu përfshihen të gjitha punimet për instalimin e këtyre rrjeteve, si dhe pajisjet dhe impiantet për vendosjen e tyre në funksion.

Kategoria A i referohet vlerës së këtyre punimeve në preventivin total dhe përcaktimeve të VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.

N.S - 4 B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar me punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese *konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dymëve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.*

Vendosja e këtij kriteri u referohet punimeve të parashikuara në projektet teknike, relacionet teknike, specifikimet, preventivin dhe grafikun e punimeve për zbatimin e veprës. Këto punime parqiten të detajuara në projektin arkitekturor dhe specifikimet e punimeve ndërtimore. Punimet e parashikuara në këtë dokumentacion teknik përfshijnë punime murature, punime dyersh dhe dritaresh, të veshjeve të

brendshme dhe të jashtme të dysHEMEVE të tipeve të ndryshme, punimeve shtresash për izolimin termoakustik dhe punime të ndryshme izolimi. Vëllimi dhe vlerat e punimeve të tilla janë të konsiderueshme. Tipologjia e mureve, veshjeve, rifiniturave, dyerve dhe dritareve në objekt është e larmishme. Për zbatimin e punimeve të tilla, VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, përcakton se duhet të disponohet licenca NS-4.

Nga sa më sipër, duke marrë në analizë të gjithë dokumentacionin teknik, specifikën e punimeve dhe vlerat e të gjithë punimeve të tilla në preventivin total të kësaj ndërhyrjeje, u vendos si kriter teknik profesional licenca NS-4 B, e cila është e domosdoshme për vlerën, rëndësinë dhe kompleksitetin e punimeve të tilla.

N.S - 12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla *konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.*

Referuar VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin, Ndarjen, Bashkimin ose Mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të Degëve të tyre”, Pika 2.c.) Standarde dhe normativa për infrastrukturën e IAL-së, paragrafi ë):

ë) Mjediset e IAL-ve duhet të jenë të pajisura me sisteme funksionuese ngrohje-ftohjeje.

Objekti i parashikuar të rikonstruohet dhe shtesa kate që do të ndërtohet do të pajiset me sistem të plotë HVAC. Ambientet në godinën e shkollës janë të përbëra nga zona me tipologji si klasa, laboratorë, sallë mbledhjesh, palestër, nyje higjienosanitare në të cilat ushtrohen aktivitete të ndryshme, por që kanë të njëjtin qëllim të përbashkët për sa i përket sigurimit të një komoditeti shkollor. Sistemi i ngrohjes/ftohjes së ambientit është planifikuar të punojë i gjithi me riqarkullim të brendshëm duke shfrytëzuar zgjerimin direkt të gazit refrigerant (*R410A*). Burimi i energjisë do të sigurohet nga makineritë e jashtme (kompresoret e gazit) të cilat do të jenë version Pompe nxehtësie me Inverter. Në projektin mekanik HVAC, duke përfshirë zgjidhjet grafike, relacionin teknik, specifikimet teknike, si dhe pjesën përkatëse të preventivit dhe grafikut të punimeve për realizimin e secilit seksion të ndërtesës janë parashikuar të gjitha punimet për ndërtimin e rrjeteve, furnizimin dhe montimin e këtij sistemi.

Për realizimin e këtyre punimeve në kriteret teknike është kërkuar që OE të zotërojë kapacitetet teknike profesionale për zbatimin e sistemit të plotë të ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit, në përputhje me zgjidhjet teknike të hartuara nga projektuesi. Vendosija e këtij kriteri kushtëzohet nga punimet e parashikuara të realizohen për kompletimin dhe përmbylljen e veprës. Nisur nga natyra e punimeve dhe vlerat e preventivit për zbatimin e tyre, është e domosdoshme që OE të jetë i pajisur me licensën respektive N.S - 12 B, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.

N.S – 13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me

çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme. Vendosja e këtij kriteri kushtëzohet nga punimet e parashikuara të realizohen për kompletimin dhe përmbylljen e veprës. Nisur nga natyra e punimeve dhe vlerat e preventivit për zbatimin e tyre, është e domosdoshme që OE të jetë i pajisur me licensën respektive sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.

N.S - 14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

Me impiante të kësaj tiplogjie, në shtjellim të N.S – 14 *konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

Projekti i zbatimit parashikon ndër të tjera zbatimin e punimeve për rrjetet elektrike dhe elektronike, të tilla si punimet për instalimin e rrjetit elektrik të furnizimit me energji, rrjetin e tokëzimit dhe rrufepritjes, ndriçimin, rrjetin lan ,etj pajisje sistemi i zbulimit dhe lajmërimit të zjarrit.

Është projektuar që çdo klasë laborator, ambjente të përbashkëta të furnizohen me energji elektrike në mënyrë të pavarur midis tyre, pra me atomat për seicilin (të pavarur nga ambjentet e tjera) si dhe rele diferenciale për çdo ambjent .

Projekti parashikon dhe ndriçim emergjence për çdo ambjent si dhe ambjentet e përbashkëta. Nga llogaritja e ngarkesave elektrike të projektuar rezulton se fuqia elektrike e instaluar është: $P_{inst}=80.6kw$

Kjo fuqi e konvertuar me koeficientët rezervë, të njëkohshmërisë dhe të ngarkesës fuqia elektrike e kërkuar do të jetë $P=57kvA$.

Punime të tilla duhet të realizohen nga subjekte të kualifikuara për realizimin e tyre, në përputhje me VKM nr.42 të datës 16.01.2008, më sipër cituar. Licenca e nevojshme për realizimin e këtyre punimeve, referuar këtij akti është N.S - 14 - Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV. Kategoria A i referohet vlerës së punimeve të tilla në preventivin e punimeve.

N.S - 18 A Punime topogjeodezike.

Punime të tilla përfshijnë zbatimin e rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, *punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

Sikurse shtjellohet në specifikimet teknike të punimeve ndërtimore, mbështetur në dokumentacionin topografik të hartuar nga projektuesi dhe dokumentacionin e pronësisë së objektit, Kontraktori duhet të kryejë transferimin e pikave referenciale dhe gjurmës së objektit në terren, si dhe çdo shërbim tjetër topografik, të nevojshëm për zbatimin e saktë të projektit.

Shtesa në kate e objektit të parashikuar të ndërtohet ka një planimetri sheshi dhe një kufi prone me formë të thyer, planimetritë e tij zhvillohen në disa nivele dhe disnivele, volumetria është komplekse dhe zbatimi jo i saktë i të projektit në të gjitha nivelet mund të çojë në dëme kolosale dhe pamundësi teknike për realizimin e duhur të këtij konstruksioni. Kategoria A i referohet vlerës totale të punimeve për

riaftësimin e territorit dhe zbutjen e efekteve negative në preventivin e projektit të zbatimit. Kriteri në fjalë, është një kërkesë e domosdoshme në përputhje të plotë me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ushtron veprimtarinë e vetë në fushën e ndërtimit dhe ka kapacitetet teknike të nevojshme për zbatimin e kontratës. Kjo është një kërkesë minimale në përpjestim me vlerën dhe rëndësinë e kontratës që prokurohet, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, dhe që ka për qëllim të provojë se operatori ekonomik ka kapacitetet teknike për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane." Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi ne toke	Punimet sipas preventivit zeri nr. (15-16) Kap 3, zeri nr. (94-98) Kap 14.	Niveli A	2,766,278 leke pa tvsh
<u>Kategoria NP-3</u>	Rikonstruksion dhe M/M godina civile dhe industriale	Punimet sipas preventivit, zeri nr (31-36,39-40) Kap 5 Punime shtresash, zeri nr (44-46) Kap 6 Punime H/izolimi dhe catije,zeri nr.(51-53,58-59) Kap 7, zeri nr (68) Kap 8 Nenshtresa dhe shtresa ne territorin e ndertesave,,zeri nr (70-71) Kap 9 Punime murature druri, zeri nr (107) Kap 18 Punime murature guri,zeri nr 108 Kap 19 punime betony dhe b/a,zeri nr (109-110)Kap 20 .Punime Hekur betoni,zeri nr (281-287) Kap 28 Analiza jashte liste,zeri nr (289-291) Kap 28 Analiza jashte liste.	Niveli B	93,873,397 leke pa tvsh
<u>Kategoria NP-4</u>	Rruge ,autostrada ,mbikalime..	Punimet sipas preventivit zeri nr (14)Kap 2 Punime shtresash,zeri nr (63,66,68)Kap 8 Punime nenshtresa dhe shtresa ne territorin e ndertesave,zeri nr (102) Kap 16,zeri nr (104-105) Kap 17,	Niveli A	3,362,391 leke pa tvsh

<u>Kategoria NP-7</u>	Ujesjelles,gazsjelles,ve pra kullimi dhe vaditje	Punimet sipas preventivit zeri nr(64-65)Kap 8 Nenshtresa dhe shtresa ne territorin e ndertesave,zeri nr (92)Kap 8 punime me sonda ne ura,zeri nr (106)Kap 17 Ndertim i veprave te artit,zeri nr (117-120) Kap Te ndryshme,zeri nr (128)Kap Ujesjelles Kanalizim i jashtem,zeri nr (193-200) Analiza jashte liste,	Niveli A	2,550,386 leke pa tvsh
<u>Kategoria NP-11</u>	Ndertime per N/Stacionet,kabinat e transformatoreve linja te tensionit te larte dhe te mesem per shperndarjen e energjise	Punimet sipas preventivit, zeri nr(201-210) Kap Analiza jashte liste,zeri nr (261) Kap Analiza jashte liste	Niveli A	1,018,737 leke pa tvsh
<u>Kategoria NP-12</u>	Punime te inxhinierise se mjedisit	Punimet sipas preventivit,zeri nr (93) Kap13 Preje e sistemim pemesh,zeri nr (100) Kap 15,Fv peme dekorative,zeri nr (101) Kap Punime te ndryshme,	Niveli A	218,728 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-1</u>	Punime per prishjen e ndertimeve	Punimet sipas preventivit zeri (1-12)Kap 1 Punime prishje,zeri nr(13) Kap 2Prishje shtrese cakelli,zeri nr (17-22)Kap 4 Heqje dyer ,dritare,zeri nr (24-30)Kap 5 Heqje shtresa dhe shkalle,zeri nr (62)Kap 8Heqje bordura trotuari, zeri nr 69 Kap 9Heqje muri me kartonxhes,zeri nr (73-74) Kap 10 Heqje zgara dhe konstruk metalike,zeri nr	Niveli A	5,747,098 leke pa tvsh

		(75-77) Kap 11 Heqje paisje H/Sanitarezeti nr (80-82)Kap 11 Instalime H/Sanitare,zeti nr (103) Kap 17 Prishje struktura betoni,		
<u>Kategoria NS-2</u>	Impiante H/Sanitare kuzhina,lavanteri M/M e tyre	Ne preventiv zeti nr (78-79,83-91) Kap 11 Instalime H/Sanitare,zeti nr (181-192)Kap Analiza jashte liste.	Niveli A	3,974 900leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-4</u>	Punime rifiniture te muratures....	Ne preventiv zeti nr (54-56,60-61)Kap 7,zeti nr(113-114)Kap 21 Punime Bojatisje	Niveli B	21,436,578leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-8</u>	Ndertime p/f prej betoni te armuar struktura metalike dhe druri	Ne preventiv zeti nr (57) Kap 7Punime tavani dhe suvatimi,zeti nr (99)Kap 15 Sinjalet dhe paisjet shtese ,zeti nr(111-112,115-116)Kap 21,Punime bojatisje ,zeti nr (121-122)Kap 23,Punime dhe instalime teknologjike,zeti nr (288) Kap 28 Analiza jashte liste	Niveli A	10,965,691leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-12</u>	Impiante teknologjik ,termik dhe te kondicionimt	Punimet sipas preventivit ,zeti nr (124-126)Kap25 Gaz e naftesjelles ,zeti nr 127 Kap 26 Punime montimi,zeti nr (129-180,267-268) Kap Analiza jashte liste,	Niveli A	11,536,598 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-13</u>	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni	Punimet ne preventiv,zeti nr (251-253,269,271-272,275)	Niveli A	782,171 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-14</u>	Impiante te brendshme elektrike ,telefonike...	Punimet sipas preventivit,zeti nr(211-250,254-260,262-266,274-279) Kap analiza jashte liste	Niveli A	11,648,254 leke pa tvsh

Kategoria NS-18	Punime topogjeodezike		Niveli A	
-----------------	-----------------------	--	----------	--

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** të përfshirë në licensën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1(nje)inxhinier ndertimi
- 1(nje) inxhinier elektrik
- 1(nje) inxhinier mekanik
- 1(nje)inxhinier hidroteknik
- 1 (një) arkitekt
- 1 (një) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;

Inxhinieret e mësipërm duhet të jenë të i siguruar dhe të figurojë me kohë të plotë në listëpagesat perkatese E-Sig për të paktën **3 (tre) muajt e fundit.**

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës, Diplomën e inxhinierit të mësipërm.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

- Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi dhe tipologji të madhe të punimeve të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e prishjes, punimet e gërmimit, punimet e shtresave, punimet e muraturës, suvatimet, hidroizolimet, sistemimet e jeshme etj. Punimet ndërtimore përbëjnë pjesën më të madhe të vëllimit të punëve për zbatimin e projektit, sikurse edhe ato më komplekset. Punimet e ndërtimit të shteses katër kate duhet të përmbushin kushtet teknike të zbatimit. Respektimi i kërkesave për qëndrueshmëri strukturore dhe qëndrueshmëri, plotësimi i kërkesave për mbrojtjen pasive nga zjarri, përdorimi i materialeve që nuk janë të dëmshëm për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve dhe saktësia në realizimin e të gjithë elementëve konstruktivë sjellin domosdoshmërinë që çdo element dhe hallkë e zbatimit të këtyre punimeve të ndiqet dhe udhëhiqet nga ekspertë të licensuar të fushës.

Zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore dhe zbatimi i punimeve strukturore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit, metodologjia e ndekur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike dhe standardet dhe kriteret e zbatimit nga ekspert inxhinier ndërtimi, i profilit strukturist. Ndjekja e të gjithë procesit ndërtimor që në fazën e pastrimit të sheshit, punimet e ngritjes së kantierit, skelerive, objekteve ndihmëse, punimet e muraturës, punimet e shtresave izoluese, realizimi i daljeve për sistemet teknike të ndërtesës realizimi i strukturës mbajtëse, punimet e përforcimit strukturor, punimet për realizimin e konstruksioneve metalike të thjeshta dhe të përbëra janë punime të parashikuara në projektet e punimeve ndërtimore dhe në preventvin respektiv. Për ndjekjen e punimeve të përgjithshme ndërtimore dhe punimeve strukturore në këte objekt të cilët duhet te perfundojne per nje periudhe dymbedhete mujore do të ishte e nevojshme që të angazhoheshin disa inxhinierë ndërtimi, nga te cilet nje ne profilin strukturist. Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe mos rëndimin e OE nga AK është kërkuar që detyrimisht të jetë në licensën e shoqërisë të paktën nje inxhinier ndertimi.

-Projekti që do të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure prokurimi përmban si komponent të tij edhe projektin HVAC. Ky projekt përmban zgjidhjet grafike, relacionin teknik, specifikimet teknike dhe preventivin e realizimit të punimeve të tilla. Realizimi i këtij projekti për të gjithë vëllimet e objektit është shumë i rëndësishëm për sigurimin e komfortit termik në ambiente. Sikurse shtjellohet në relacionin teknik përkatës, parametrat projektuese të projektit janë marrë në përputhje me tipin dhe destinacionin e objektit dhe ambienteve të veçanta të tij...Sigurimi i një komforti termik të përshtatur për secilin ambient duke veçuar tipologjitë e veçanta funksionale, të tilla si salla mësimi, laboratorë me nxenes, zyra mesuesish dhe zyra administrative është domosdoshmëri. Nisur nga vëllimi i punimeve, sjell nevojën që minimalisht të angazhohen në zbatimin e punimeve dy eksperte inxhinierë mekanikë të licensuar. Vëllimi i madh i punës mund të përballohet duke parashikuar edhe një inxhinier mekanik, i cili mund të jetë ose jo detyrimisht i përfshirë në licencën e shoqërisë. Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe mos rëndimin e OE nga AK është kërkuar që detyrimisht të jetë në licensën e shoqërisë të paktën një inxhinier mekanik. Inxhinieri i detyrues i licensuar i nevojshëm mund të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë, ose mund të jetë i pajisur me licensë profesionale individuale.

-Objekti i parashikuar të rikonstruktohet do të përmbajë një numër të konsiderueshëm tualetesh higjieno – sanitare. Krahas tyre një numër i konsiderueshëm laboratorësh duhet të jenë të pajisur me lavamanë dhe furnizim me ujë. Për realizimin e projektit hidroteknik të godinës, zbatuesi duhet të mbështetet në projektin, relacionin, specifikimet teknike, preventivin dhe grafikun e punimeve hidroteknike. Punimet duhet të realizohen në përputhje me zgjidhjet teknike dhe specifikimet e projektuesit. Për drejtimin teknik të këtyre punimeve është e nevojshme që të angazhohen minimalisht një inxhinier hidroteknik që të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë.

-Punimet elektrike përfshijnë zëra me vlera të konsiderueshme në preventivin total të punimeve. Zërat e përfshirë në preventiv shoqërohen me zgjidhjet teknike të hartuara nga eksperti inxhinier elektrik në projekt, në relacionin teknik dhe specifikimet teknike. Të tilla punime janë punimet për kuadrot elektrike, sistemi i mbrotjtës nga shkarkimet atmosferike dhe tokëzimi, tokëzimi i përsëritur të kuadri kryesor i godinës. Për këtë arsye, lind nevoja që për zbatimin e punimeve në të gjitha vëllimet e objektit të angazhohen minimalisht një inxhinier elektrik i licensuar i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë. Kërkesa e AK lidhur me inxhinierin elektrik është kufizuar në minimalisht një drejtues teknik të shoqërisë, me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes.

-Referuar preventivit të punimeve është e nevojshme prezenca e Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.

- Projekti arkitekturor duhet të zbatohet në përputhje me konceptin e përgjithshëm arkitekturor të projektit të zbatimit të hartuar nga projektuesi arkitekt. Zërat e punimeve që përfshin ky projekt përmbajnë ndër të tjera punime të rifiniturave, punimet e dyerve, dritareve dhe fasadave etj. Këta zëra punimesh u nështrohen kërkesave të projektit arkitekturor të zbatimit, kërkesave estetike, higjieno – sanitare, funksionale të specifikuara në këtë projekt. Konceptimi i brendshëm hapsinor duhet të respektojë rigorozisht zgjidhjet teknike të hartuara nga projektuesi arkitekt. Zgjidhjet planimetrike – hapsinore të projektit në fjalë janë relativisht komplekse. Është e rëndësishme që në vëllimet që ndërtohen të vendoset për përdorimin e materialeve në ndërtesë, ngjyrave të

ndryshme të materialeve, duke i shërbyer anës estetike, ekuilibrit të ndërtesës në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi. Në përputhje me specifikimet teknike të punimeve ndërtimore, që shoqërojnë projektin arkitekturor, punë të caktuara duhet të projektohen dhe instalohen nga ekspertë të veçantë. Këtu përfshihen fasadat me sistemin e Përbërë i Integruar i Termoizolimit të Jashtëm, të gjitha punimet dhe strukturat metalike, të gjitha dyert e veçanta (p.sh.: dyert anti-zjarr apo të sigurisë), etj. Për zbatimin e saktë të projektit të zbatimit arkitekturor, i cili sikurse është shtjelluar më sipër është kërkuar angazhimi i një arkitekti të licensuar i cili të jetë jodomsdoshmerisht në licensën e shoqërisë.

2.3.4 Vetdeklarimin nga inxhinierët e mësipërm si dhe nga arkitekti se ata janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontratë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar ne Rekomandimin Nr. 6732, date 21.10.2020 "Mbi Problematikat e konstatuara gjate monitorimit nga APP".

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithe kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas perqindjes se bashkepunimit.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", "Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie" ne nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe ligjin 8402 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" date 10.09.1998 i ndryshuar.

2.3.6 Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë

individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, është e mjaftueshme që të paktën njëri prej Operatorëve të ketë pjesë të stafit të Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin”).

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për specialistin Ekspert Zjarrfikës është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Ligjit Nr. 152/2015 “Per shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin”.

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkakimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin.

2.3.7 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- a) 1 (një) punonjes i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, është e mjaftueshme që të paktën njëri prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”).

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

- b) 1 (një) punonjës me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. ((Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, është e mjaftueshme që të paktën njëri prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”).

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çenojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

Gjithashtu, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen të cilat kanë potencial të shkaktimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1 (një) punonjesi te pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjesve të siguruar për **muajin e fundit** duhet te jetë **70 (shtatëdhjetë)**.

Lidhur me këte pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjesve të siguruar për periudhen e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatase E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Afati 12 (dymbëdhjete) muaj.

Sasia e oreve të punës sipas manualit është 118836 ore pune.

Nevojiten:

- 1- Muratori nevojitet per kryerjen e punimeve te ndryshme te ndertimit .Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte $56896:8:264=33$ puntore
 - 2-Mekaniku nevojitet per kryerjen e punimeve mekanike ne objekt.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte $1093:8:88=1.5$ punonjes
 - 3-Bojaxhiu nevojitet per kryerjen e punimeve te bojatisjes.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $3204:8:88=5$ puntore
 - 4-Instalues i sistemit te ngrohjes nevojitet per kryerjen e punimeve te te impianteke teknologjik termik dhe te kondicionimit. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $2182:8:88=3.09$ puntore
 - 5-Elektriciqisti nevojitet per kryerjen e punimeve elektrike. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $3575:8:88=1.6$ puntore
 - 6-Hidrauliku nevojitet per kryerjen e punimeve hidraulike. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $711:8:120=0.74$ puntore.
 - 7- Marangoz nevojitet per kryerjen e punimeve te shtreses se parketit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $2187:8:88=3.10$ puntore.
 - 9-Hekurkthyesi nevojitet per kryerjen e punimeve te hekurit .Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $7276:8:176=5.16$ punonjes.
 - 10- Saldator 1 (nje) punonjes nevojiten.
 - 11- Karpentier 2 (dy) punonjes
 - 12-Punonjes te montimit te skelerive nevojitet per montimin e skelerive per punimet ne objekt. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $10080:8:198=6.36$ punonjes
 - 13-Specialist te punimeve te gipsit nevojitet per kryerjen e punimeve te gipsit ne object sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $4796:8:264=2.2$ punonjes
 - 14-Punonjes d/a nevojitet per kryerjen e punimeve te d/a sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $3773:8:264=1.78$ punonjes
 - 15-Punetore ndihmesa të specialisteve 3 (tre) punonjes
 - 16- Hidroizolues 1(nje) punonjes
 - 17- Specialist IT 1 (një) punonjës
- Totali 71.53 punonjes

Ne lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kerkese eshte e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të

parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **muajin e fundit**, të paisur me kontrate pune (te vlefshme), diplome leshuar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore/organe/institute të akredituar, ose të kontraktuar posacerisht për të realizuar këto kontrate në rastin kur makineritë janë me qera për manovratorët, ku nga këta të jenë të paktën::

Teknik ndertimi	1 (nje) punonjes
Murator	5 (pese) punonjës
Mekanik	1 (nje) punonjes
Bojaxhi	2 (dy) punonjes
Elektricist	1 (një) punonjes
Hidraulik	1 (një) punonjes
Hidroizolues	1 (nje) punonjes
Hekurkthyes	2 (dy) punonjes
Saldator	1 (një) punonjës
Manovrator	2 (dy) punonjes
Specialiste instalues të sistemeve te ngrohjes (kaldajave)	2 (dy) punonjes
Specialist IT	1 (një) punonjës
Marangoz	2 (dy) punonjes
Karperntier	2 (dy) punonjës

Për stafin teknik të mësipërm, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës te vlefshme;
- diplomën e shkolles/deshmi nga organe/institute të akredituar që të vërtetojë kualifikimin profesional të punonjesve të mësipërm;
- Manovratorët duhet të jenë punonjës i specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda (Eskavatorist) ose (Automakinist) dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit të Transportit Rrugor

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Nevojiten:

- 1- Muratori nevojitet për kryerjen e punimeve të ndryshme të ndertimit. Sasia e orëve të punës sipas manualit është $56896:8:264=33$ puntore
- 2-Mekaniku nevojitet për kryerjen e punimeve mekanike në objekt. Sasia e orëve të punës sipas manualit është $1093:8:88=1.5$ punonjes
- 3-Bojaxhiu nevojitet për kryerjen e punimeve të bojatisjes. Sasia e orëve të punës sipas manualit është: $3204:8:88=5$ puntore

- 4-Instalues i sistemit te ngrohjes nevojitet per kryerjen e punimeve te te impianteke teknologjik termik dhe te kondicionimit. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $2182:8:88=3.09$ puntore
- 5-Elektriçisti nevojitet per kryerjen e punimeve elektrike. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $3575:8:88=1.6$ puntore
- 6-Hidrauliku nevojitet per kryerjen e punimeve hidraulike. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $711:8:120=0.74$ puntore.
- 7- Marangoz nevojitet per kryerjen e punimeve te shtreses se parketit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $2187:8:88=3.10$ puntore.
- 9-Hekurkthyesi nevojitet per kryerjen e punimeve te hekurit .Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $7276:8:176=5.16$ punonjes.
- 10- Saldator 1 (nje) punonjes nevojiten.
- 11- Karpentier 2 (dy) punonjes
- 12-Punonjes te montimit te skelerive nevojitet per montimin e skelerive per punimet ne objekt. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $10080:8:198=6.36$ punonjes
- 13-Specialist te punimeve te gipsit nevojitet per kryerjen e punimeve te gipsit ne object sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $4796:8:264=2.2$ punonjes
- 14-Punonjes d/a nevojitet per kryerjen e punimeve te d/a sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $3773:8:264=1.78$ punonjes
- 15-Punetore ndihmesa të specialisteve 3 (tre) punonjes
- 16- Hidroizolues 1(nje) punonjes
- 17- Specialist IT 1 (një) punonjës
- 18-teknik ndertimi nevojitet per mbikqyerjen e punimeve ne object
- 19-Manovrator 2(dy) punonjes per drejtimin e makinerive qe do te perdoren ne objekt

Totali 71.53 punonjes

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Te gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë te lëshuara nga instuticione te licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga instuticione të

licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se. Kërkesa për deshmite e manovratoreve bazohet në Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”.

2.3.10 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit:

Nr	Mjetet	Sasia
1	Mjet transporti vetëshkarkues mbi 7 ton (kapac.mbajtes)	2 copë
2	Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5 - 5 Ton	1 copë
3	Betoniere	1 copë
4	Matrapik	1 copë
5	Eskavator 0.25m ³ me gome	1 copë
6	Skeleri	1000 m ²
7	Trapano	1 copë
8	Elektrosaldatrice	1 copë
9	Pompë suvatimi	1 copë
10	Autovinc	1 cope
11	Vinç kullë 4-6 ton	1 copë
12	Zmerilatrice	1 cope
13	Rrul	1cope
14	Grejder	1 cope
16	Fadrome	1 cope
15	Autobot uji	1 cope
16	Elektroorgano	1 cope
17	Autobetoniere	1 cope
18	Autopompe Betoni	1 copë

Si deshmi për plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).

- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Periudha e garancisë për defektet është 2 vjet pas marrjes në dorëzim të objektit (hartimit të procesverbalit të marrjes në dorëzim dhe certifikatës).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimeve sipas zërave përkatës të Preventivit.

Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë.

Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kerkuar ne funksion te kryerjes se zerave specifike te punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve të punimeve përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm të vërtetohet se zotëron kualifikimet e nevojshme

teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Mjet transporti vetshkarkues mbi 7 ton (ngarkesa)

Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5 - 5 Ton

Transport dhera m^3 $3819 \cdot 1.6 = 6110$ ton

Transport inerte m^3 $500 \cdot 1.8 = 900$ ton

Transport material të ndryshme -200 ton

Totali 7210 ton : 64=112,6 ton, mesatarisht 16 rrugë ne ditë

Betoniere nevojitet për përgatitjen e llaçeve dhe betoneve sipas zërave të preventivit.

Eskavatori nevojitet për realizimin e punimeve të germimit të themeleve dhe plintave dhe punime rrugore

Elektroorgano nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit

Matrapiku nevojitet për realizimin e punimeve te prishjes.

Skelerite nevojitet për kryerjen e punimeve ne lartesi sipas zerave te preventivit.

Autovinçi nevojitet për kryerjen e punimeve elektrike sipas zerave te preventivit

Rruli nevojitet për ngjeshjen e shtresave rrugore sipas projektit.

Autoboti ujit nevojitet për lagien me uje te shtresave te inerteve para ngjeshjes.

Grejderi nevojitet për hapjen dhe nivelimin e shtresave te inerteve sipas projektit.

Fadroma nevojitet për grumbullimin e mbeturinave ndertimore nga objekti dhe ngarkimin ne mjet.

Trapano nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit

Zmerilatriçe nevojitet për rrashinimin e shtreses se parketit

Elektrosaldatriçe nevojitet për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit

Autobetoniera nevojitet për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit

Autopompë betoni nevojitet për kryerjen e procesit të betonimit ne objekt

Pompë suvatimi nevojitet për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit

2.3.11 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, per objektin qe prokurohet, te cilat duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara, sipas standardeve:

- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (për sistemin e menaxhimit te cilesise)**, e vlefshme. *Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotesohet nga te gjithë anetaret e BOE.*
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 (për sistemin e menaxhimit te mjedisit)**, e vlefshme. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotesohet nga te gjithë anetaret e BOE.*
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 45001-2018 (për sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune)**, ose cetifikaten ekuivalente, e vlefshme, *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotesohet nga te gjithë anetaret e BOE.*
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 50001:2018 (për sistemin e menaxhimit te energjise)**, e vlefshme. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotesohet nga anetari qe do te kryeje punimet e perkatese.*

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001-2018 është një standard i ri i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi), të reduktojë kostot energjetike të kompanive, emisionet e gazrave serë (GHG) dhe impaktet e tjera në mjedis. Në Preventivin e punimeve parashikohen zëra elektrik, ku zbatimi i tyre kërkon që Ofertuesi të jetë i pajisur me Certifikatë ISO 50001-2018. Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

***Kujdes:** Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*